VENDIM
Nr. 59, datë 14.11.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:
Holta Zaçaj kryetare,
Marsida Xhaferllari anëtare,
Fiona Papajorgji anëtare,
Elsa Toska anëtare,
Sonila Bejtja anëtare,
Sandër Beci anëtar,
Genti Ibrahimi anëtar,
Marjana Semini anëtare,
me sekretare Belma Lleshi, më datë 14.11.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (K) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Kujtim Hoxha

SUBJEKT I INTERESUAR: Agjencia e Trajtimit të Pronave

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-4492 (413), datë 1.12.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 46 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), neni 1 i protokollit nr. 1 dhe neni 1 i protokollit nr. 12 të saj; nenet 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Agjencisë së Trajtimit të Pronave (*ATP*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Kujtim Hoxha është një nga trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar A.H. dhe në këtë cilësi, por edhe si përfaqësues i trashëgimtarëve ligjorë të subjekteve të tjera të shpronësuar, F.H. dhe E.H., i është drejtuar Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*ZRKKP*), qarku Vlorë për njohjen, kthimin ose kompensimin e disa pasurive të paluajtshme që ndodhen në fshatin Borsh, komuna Lukovë, rrethi Sarandë.

2. ZRKKP-ja, qarku Vlorë, me vendimet nr. 339 dhe nr. 340, datë 24.9.2008, ka vendosur të njohë të drejtën e pronësisë dhe kthimin e sipërfaqeve tokë bujqësore respektivisht 4,000 m^2 dhe 16 dynym, të cilat ndodhen në fshatin Borsh, komuna Lukovë, rrethi Sarandë, sipas kufijve përkatës.

3. Me vendimet nr. 3837/5 prot. dhe nr. 3837/6 prot., datë 3.4.2009, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*AKKP*), bazuar në pikën 1/c, të nenit 16 dhe pikën 1/b, të nenit 18, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave" (*ligji nr. 9235/2004*), pasi ka marrë në shqyrtim kryesisht vendimet nr. 339 dhe nr. 340, datë 24.9.2008 të ZRKKP-së, qarku Vlorë, ka vendosur shfuqizimin e tyre dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në qark.

4. Duke i konsideruar këto vendime si akte administrative absolutisht të pavlefshme, kërkuesi i është drejtuar me padi gjykatës për kundërshtimin e tyre. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 12383, datë 17.12.2012, ka vendosur të pranojë kërkesëpadinë duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të akteve administrative nr. 3837/5 prot. dhe nr. 3837/6 prot., datë 3.4.2009 të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së dhe duke lënë në fuqi vendimet nr. 339 dhe nr. 340, datë 24.9.2008 të ZRKKP-së, qarku Vlorë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim në gjykatën e apelit pala e paditur në procesin gjyqësor AKKP-ja.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2322, datë 28.5.2014, bazuar në vendimet unifikuese nr. 3, datë 6.12.2013 (*nr. 3/2013*) dhe nr. 4, datë 10.12.2013 (*nr. 4/2013*) të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka shpallur moskompetencën e saj dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit, duke vlerësuar se mosmarrëveshja në gjykim ka vetëm një kërkim, i cili është me natyrë administrative.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3342, datë 10.9.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 12383, datë 17.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs pala e paditur, AKKP-ja.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-4492 (413), datë 1.12.2022, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 3342, datë 10.9.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim gjykatës kompetente, Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Sipas tij, bazuar në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 4/2013, mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës civile, pasi ka të bëjë me kundërshtimin e vendimit të AKKP-së dhe rregullimin e pasojave, pra njohjen e pronësisë, si dhe kthimin ose kompensimin e saj në kuptim të ligjit.

8. Më datë 30.3.2023 kërkuesi Kujtim Hoxha i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij. Me vendimin e datës 31.5.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 19.6.2023, ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtari të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, dhe me vendim të së njëjtës datë, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

9. Ligji nr. 133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 9235/2004 që parashikonte si organ përgjegjës AKKP-në, ka përcaktuar ATP-në si organin që ushtron përgjegjësitë e ngarkuara prej tij për përfundimin e procesit të njohjes së pronësisë dhe kthimit apo kompensimit sipas rastit, si dhe përfundimin e procesit të kompensimit përmes ekzekutimit të vendimeve të miratuara për kompensim. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi emrat e këtyre institucioneve janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës që janë kryer veprime prej tyre.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të:

10.1 *Parimit të sigurisë juridike,* pasi Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim dhe ka pranuar një rekurs të paraqitur jashtë afatit ligjor. ATP-ja ka marrë dijeni për vendimin e gjykatës së apelit me njoftimin e datës 22.9.2014, ndërsa rekursi mban datën 14.11.2014, pra është dukshëm tej afatit 30-ditor. Kalimi i afatit ligjor e shndërron vendimin e gjykatës së apelit në gjë të gjykuar me të gjitha atributet kushtetuese dhe ligjore sipas nenit 142, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Për rrjedhojë, pala që nuk ka respektuar afatin e ankimit humb të drejtën e ushtrimit të ankimit të fundëm të zakonshëm të parashikuar nga ligji procedural. Vendimi i Kolegjit Administrativ vjen në kundërshtim me standardet kushtetuese dhe konventore të prekluzivitetit të ankimit, pasi kalimi i afatit shuan të drejtën e ankimit dhe bashkë me të edhe të drejtën e aksesit në juridiksionin gjyqësor rishikues.

10.2 *Standardit të arsyetimit të vendimit,* pasi arsyetimi i Kolegjit Administrativ në lidhje me afatin e paraqitjes së rekursit nuk mbështetet në provat, faktet e dokumentet e administruara gjatë seancës

gjyqësore, për më tepër ai ka bërë shtrembërim të tyre dhe ka mbajtur qëndrim të njëanshëm. Në vendim nuk është përmendur pohimi gjyqësor i Avokaturës së Shtetit, si përfaqësuese e palës së paditur, lidhur me datën 22.9.2014, si datë e marrjes dijeni për vendimin e arsyetuar të gjykatës së apelit. Po kështu, edhe në lidhje me themelin, Kolegji Administrativ ka shtrembëruar faktet dhe rrethanat të cilat rezultojnë të pavërteta nga përmbajtja e rekursit. Ndryshe nga sa arsyetohet në vendim, shkaqet e parashtruara në rekurs nuk bëjnë pjesë në ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (*ligji nr. 49/2012*). Vendimi është alogjik dhe ka arritur në konkluzion të gabuar në lidhje me natyrën e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, pasi ajo ka të bëjë me pavlefshmërinë absolute të akteve administrative të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së dhe kërkuesi nuk ka kërkuar njohje, kthim, kompensim ose ndonjë kërkim tjetër të natyrës civile. Për më tepër, çështja është gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit pas shpalljes së moskompetencës nga Gjykata e Apelit Tiranë, vendim ky që nuk është kundërshtuar nga palët në gjykim në një gjykatë më të lartë.

11. ***Subjekti i interesuar, ATP-ja,*** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i" dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

14. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive,* që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: *i)* kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet Gjykatës; *ii)* kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion. Ai përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha shkallëve të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 8, datë 19.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren se objekt i kërkesës në shqyrtim është kundërshtimi i vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë gjykatës kompetente, Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se vendime të këtij lloji nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste, kur procesi i themelit vazhdon

të jetë në gjykim, kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjykimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë *(shih vendimet nr. 39, datë 6.7.2016; nr. 48, datë 6.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

16. Megjithatë, përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, kontrollit kushtetues mund t'i nënshtrohen edhe vendime të tjera me natyrë jo përfundimtare, që jepen gjatë një procesi gjyqësor, nëse plotësohen disa kritere që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj së drejtës kushtetuese të individit. Në këtë kuptim, shkelja e pretenduar në rastin konkret lidhet pikërisht me faktin se, edhe pse gjykimi për objektin e padisë është ende në shqyrtim në gjykatën e apelit, për rrjedhojë vendimi i kundërshtuar nuk konsiderohet përfundimtar në atë drejtim, është natyra e pretendimit të ngritur, përkatësisht shkelja e parimit *res judicata*, që justifikon shqyrtimin e kësaj çështjeje në nivel kushtetues. Për sa kohë që një shkelje e tillë dhe pasojat e saj nuk mund të riparohen më gjatë rigjykimit të çështjes, pra në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka mjete të tjera ligjore efektive në dispozicion për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara, ndaj ai legjitimohet për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

17. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 1.12.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë më datë 30.3.2023, pra brenda afatit 4-mujor.

18. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se edhe pse nuk është formuluar në mënyrë të shprehur nga kërkuesi, në thelb, pretendimi se Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim dhe ka pranuar një rekurs të paraqitur jashtë afatit ligjor 30-ditor, kalimi i të cilit e ka shndërruar vendimin e gjykatës së apelit në gjë të gjykuar *res judicata*, ka të bëjë me parimin e sigurisë juridike, i cili, si pretendim me natyrë kushtetuese, do të shqyrtohet në vijim në lidhje me bazueshmërinë në themel. Për më tepër, në këndvështrim të këtij parimi, Gjykata do të vlerësojë edhe mënyrën e arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë për këtë aspekt.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e parimit të sigurisë juridike

19. Sipas kërkuesit, ATP-ja ka marrë dijeni për vendimin e gjykatës së apelit me njoftimin e datës 22.9.2014, ndërsa rekursi mban datën 14.11.2014, pra është paraqitur dukshëm tej afatit ligjor 30-ditor. Kalimi i afatit ligjor e shndërron vendimin e gjykatës së apelit në gjë të gjykuar me të gjitha atributet kushtetuese dhe ligjore sipas nenit 142, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 451/a të KPC-së. Për rrjedhojë, pala që nuk ka respektuar afatin e ankimit humb të drejtën e ushtrimit të ankimit të fundëm të zakonshëm të parashikuar nga ligji procedural. Vendimi i Kolegjit Administrativ është në kundërshtim me standardet kushtetuese dhe konventore të prekluzivitetit të ankimit, pasi kalimi i afatit shuan të drejtën e ankimit dhe bashkë me të edhe të drejtën e aksesit në juridiksionin gjyqësor rishikues.

20. Në funksion të parimit të sigurisë juridike, Gjykata ka pranuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve ligjore të përcaktuara. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Mospërcaktimi i tyre do të çonte në një situatë të tillë, ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej ose prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë *(shih vendimet nr. 27, datë 18.5.2023; nr. 29, datë 15.5.2014; nr. 5, datë 2.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Në rastin kur kushtet e paraqitjes së ankimit ose padisë, siç është afati, janë përcaktuar nga ligji, Gjykata ka vënë në dukje rëndësinë kushtetuese që ka zbatimi dhe interpretimi i dispozitave ligjore nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë Gjykatën e Lartë, me qëllim që individit t'i garantohet procesi i rregullt në aspektet e aksesit në gjykatë dhe të mbrojtjes efektive *(shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*. Respektimi i afatit ligjor për paraqitjen e rekursit lidhet me parimin e sigurisë juridike, i cili, mes të tjerash, garanton qëndrueshmërinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si edhe besueshmërinë e individit te

shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 62, datë 31.7.2017; nr. 2, datë 29.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022. nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në ushtrimin e kontrollit të kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor, Gjykata vlerëson dhe interpreton faktet e çështjes vetëm në funksion të pretendimeve me natyrë kushtetuese, me qëllim vlerësimin prej saj të respektimit të së drejtës së pretenduar të cenuar. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se me vendimin e datës 10.9.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të akteve administrative të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, duke lënë në fuqi vendimet e ZRKKP-së, qarku Vlorë për njohjen e së drejtës së pronësisë trashëgimtarëve ligjorë të subjekteve të shpronësuara. Referuar akteve të dosjes gjyqësore, të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, çështja në gjykatën administrative të apelit është shqyrtuar në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve. Në dëftesën e njoftimit të vendimit të gjykatës së apelit për palën e paditur, AKKP-në, ndodhet vula e institucionit, në të cilën është shënuar data 22.9.2014, por nuk ka nënshkrim të personit që e ka marrë atë në dorëzim. Më datë 17.11.2014 në gjykatën e shkallës së parë është depozituar rekursi i AKKP-së, në të cilin ky organ është shprehur se rezervon të drejtën të japë shpjegime të tjera për vendimin e gjykatës së apelit në seancë gjyqësore, në kushtet që ai vendim nuk është zbardhur (*shih faqen 2 të rekursit*).

24. Në seancën gjyqësore të datës 5.10.2022, në dhomën e këshillimit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në prani të palëve. Në seancën gjyqësore të datës 17.11.2022, pyetjes së gjykatës nëse është në dijeni për mënyrën dhe datën e marrjes dijeni të vendimit të gjykatës së apelit nga organi publik, AKKP-ja, Avokatura e Shtetit i është përgjigjur se përveç rekursit të depozituar nuk ka akte të tjera. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi është tërhequr në dhomën e këshillimit për verifikimin e aktit për komunikimin e vendimit të gjykatës së apelit, u ka vënë në dispozicion palëve në proces kopje të dëftesave të komunikimit të administruara në fashikullin gjyqësor dhe i ka lënë detyrë Avokaturës së Shtetit që të verifikojë pranë organit publik që përfaqëson, ATP-së, se në ç'mënyrë ka marrë dijeni për vendimin e gjykatës së apelit, duke bashkëlidhur edhe aktet korresponduese, libër protokolli nëse ka pasur ose libër poste, ose personi që mund ta ketë marrë pranë sekretarisë së gjykatës në emër të institucionit, si dhe çdo e dhënë që mund të disponohet. Për këtë arsye, Kolegji Administrativ ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore.

25. Në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Avokatura e Shtetit, me shkresën e datës 23.11.2022, ATP-ja ka informuar se nga verifikimet në arkivin e këtij institucioni ndodhet i depozituar regjistri nr. 10, zyrtare 2014, në të cilin rezulton se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nr. 3342, datë 10.9.2014 është administruar në AKKP me nr. 15506, datë 22.9.2014. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 1.12.2022, i administruar në dosjen gjyqësore, në përgjigje të pyetjes së gjykatës se kur ka marrë dijeni ATP-ja për vendimin, përfaqësuesi i Avokaturës së Shtetit ka konfirmuar po atë datë. Në po këtë seancë, Gjykata e Lartë ka administruar aktet shkresore të paraqitura nga Avokatura e Shtetit, ka dëgjuar palët dhe në përfundim ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës administrative të apelit dhe kthimin e çështjes gjykatës kompetente, Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

26. Në lidhje me afatin e paraqitjes së rekursit, në vendimin e Kolegjit Administrativ është arsyetuar se njoftimi i vendimit është i parregullt, në kuptim të nenit 122 të KPC-së, pasi referuar dëftesës së komunikimit ajo përmban vetëm vulën e institucionit dhe nuk përmban numër

protokolli dhe personin që ka marrë dijeni. Për rrjedhojë, kjo mënyrë komunikimi vë në dyshim dijeninë e palës së paditur dhe konsiderohet në favor të personit të cilit i cenohen të drejtat, për sa kohë që edhe në përmbajtje të rekursit është pretenduar plotësimi i tij me shkaqe të tjera, pasi pala e paditur të njihet me arsyetimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit (*shih paragrafin 17 të vendimit nr. 00-2022-4492 (413), datë 1.12.2022 të Kolegjit Administrativ*).

27. Neni 44 i ligjit nr. 49/2012 referon te KPC-ja në lidhje me mjetet dhe afatet e ankimit. Sipas dispozitave të KPC-së në fuqi në kohën e paraqitjes së rekursit, rezulton se neni 443 parashikon se afati për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë. Kurse sipas nenit 444, afatet e caktuara në nenin 443 janë të prera dhe fillojnë nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit përfundimtar dhe kur çështja është gjykuar në mungesë të njërës palë, afati fillon nga dita e njoftimit të vendimit. Sipas nenit 447 të KPC-së, ankimi u njoftohet palëve sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të titullit VI të pjesës I të këtij kodi, për njoftimet e thirrjet në gjykatë. Në lidhje me rregullat e njoftimit shkresor të akteve, neni 130 i KPC-së parashikon se njoftimi shkresor në rastin e personave juridikë publikë bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve.

28. Në kuptim të sa më sipër dhe referuar fakteve që kanë rezultuar gjatë këtij gjykimi kushtetues, Gjykata arrin në përfundimin se vendimi i gjykatës së apelit i është njoftuar palës së paditur (*AKKP-së*) më datë 22.9.2014, datë që jo vetëm rezulton nga vula e vendosur në dëftesën e komunikimit por edhe nga regjistri i dokumenteve të hyra në institucion, i plotësuar nga personi i ngarkuar me pranimin e akteve. Nga ana tjetër, ky fakt është pranuar edhe gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë nga Avokatura e Shtetit, si përfaqësuese e palës së paditur. Këto fakte, në vlerësimin e Gjykatës janë të mjaftueshme për të provuar se pavarësisht mënyrës se si është plotësuar dëftesa e komunikimit nga nëpunësi që e ka marrë në dorëzim atë, data 22.9.2014 është ajo nga e cila ka filluar të ecë afati 30-ditor për paraqitjen e rekursit. Me përfundimin e këtij afati (data 22.10.2014), vendimi i gjykatës së apelit ka marrë formë të prerë dhe përbën gjë të gjykuar. Gjykata e Lartë jo vetëm që i ka anashkaluar këto fakte, por edhe pse ka pranuar se rekursi është paraqitur më datë 14.11.2014, pra me 22 ditë vonesë, nuk ka administruar asnjë provë dhe nuk ka argumentuar, për rrjedhojë, një moment të ndryshëm nga i cili ka nisur ky afat. Kolegji Administrativ e ka bazuar vendimin e tij në qëndrimin e mbajtur në rekurs nga titullari i AKKP-së (pala e paditur), i cili ka deklaruar se plotësimi i rekursit do të bëhej pasi të njihej me arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit. Megjithatë Kolegji Administrativ nuk ka argumentuar qëndrimin e tij në lidhje me afatin e paraqitjes së rekursit dhe momentin nga i cili ka nisur të ecë ky afat për palën gjyqhumbëse.

29. Sipas GJEDNJ-së, një kërkesë e paraqitur pasi një vendim është bërë i formës së prerë dhe i detyrueshëm nuk mund të përbëjë bazë për mosrespektimin e parimit *res judicata* (*shih Tığrak kundër Turqisë, datë 6.7.2021, §§ 58-63*). E drejta për të paraqitur padi ose ankim duhet të lindë nga momenti kur palët mund të njihen efektivisht me një vendim ligjor që vendos detyrime për to ose që mund të dëmtojë të drejtat ose interesat e tyre të ligjshëm. Përndryshe, gjykatat mund të zvogëlojnë ndjeshëm kohën për paraqitjen e ankimit apo edhe ta bëjnë të pamundur paraqitjen e tij duke vonuar dorëzimin e vendimeve të tyre. Si mjet komunikimi mes organit gjyqësor dhe palëve, njoftimi ua bën të njohura këtyre të fundit vendimin gjyqësor dhe arsyet e tij, duke u mundësuar që ta kundërshtojnë nëse e shohin të arsyeshme (*shih Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës, datë 25.1.2000, § 37*). Pranimi i një ankimi të paraqitur jashtë afatit dhe pas një periudhe të konsiderueshme kohore, për arsye që nuk duken veçanërisht bindëse, mund të sjellë shkelje të parimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës për gjykatë. Në lidhje me parimin *res judicata* si shkelje është konsideruar edhe rasti i zgjatjes së afatit kohor për përdorimin e një mjeti juridik të zakonshëm duke lejuar ankimin jashtë afatit të palës gjyqhumbëse. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se mungesa e kujdesit të duhur nga organi publik dhe nëpunësit e tij, nuk është e tillë që të vërë në dyshim vlefshmërinë e aktit të njoftimit apo mungesën e dijenisë për vendimin e kundërshtuar. Edhe nëse nevoja për të korrigjuar gabimet gjyqësore mund të lindë në parim nga konsiderata legjitime, kjo nuk duhet të bëhet në mënyrë arbitrare dhe, në çdo rast, autoriteteve u kërkohet që të ruajnë, për aq sa është e mundur, një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave të kërkuesit dhe

nevojës për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë (*shih Magomedov dhe të tjerë kundër Rusisë, datë 28.3.2017, §§ 87–89, 95*).

30. Në përputhje me sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pranimi i rekursit të paraqitur jashtë afatit ligjor, pa arritur të provojë rekursuesi (pala e paditur në procesin gjyqësor) se ka qenë në pamundësi efektive për t'u njohur me vendimin e gjykatës së apelit ose momentin se kur është njohur efektivisht me arsyetimin e tij, ka cenuar parimin e sigurisë juridike. Interpretimi dhe qëndrimi i Gjykatës së Lartë ka sjellë faktikisht zgjatjen e afatit kohor për përdorimin e një mjeti të zakonshëm ankimi, ndërkohë që legjislacioni në fuqi ka parashikuar mjete juridike në dispozicion të palëve që kanë humbur ose tejkaluar afatet procedurale. Në rastin konkret është provuar se organi publik nuk ka treguar kujdesin e duhur, si në administrimin e akteve të brendshme, ashtu edhe në respektimin e afateve ligjore për paraqitjen e rekursit. Kjo sjellje nuk mund të vërë në dyshim vlefshmërinë e aktit të njoftimit dhe nuk mund të përbëjë argument për të justifikuar mungesën e dijenisë për vendimin e kundërshtuar, aq më tepër kur vetë përfaqësuesi i organit publik (Avokatura e Shtetit) ka pohuar gjatë procesit gjyqësor marrjen dijeni, fakt ky i pasqyruar edhe në procesverbalin e seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë nuk ka vënë në balancë respektimin e parimit të sigurisë juridike që i garanton mbrojtje palës gjyqfituese në proces (kërkuesit) përkundrejt së drejtës së aksesit dhe të ankimit në një gjykatë më të lartë të palës gjyqhumbëse (subjektit të interesuar), duke vendosur në favor të kësaj të fundit.

31. Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, për më tepër, nuk ka arsyetuar në vendimin e saj se përse e ka konsideruar të parregullt dëftesën e komunikimit të vendimit, në kuptim të nenit 122 të KPC-së, edhe pse përfaqësuesi i palës së paditur, Avokatura e Shtetit, si palë e interesuar në gjykim, nuk ka paraqitur asnjë pretendim për parregullsi dhe pavlefshmëri të dëftesës së komunikimit, përkundrazi ka pranuar dhe ka konfirmuar si datë të njoftimit të vendimit atë që ka rezultuar edhe nga provat e administruara në gjykim. Gjykata e Lartë ka vlerësuar kryesisht rregullsinë e aktit në kundërthënie edhe të qëndrimit të vetë asaj pale.

32. Nga ana tjetër, faktet e administruara gjatë gjykimit, të cituara në funksion të vendimmarrjes për parimin e sigurisë juridike (*shih paragrafët 23–26 më sipër*), nuk janë pasqyruar në mënyrë të plotë në vendimin e Gjykatës së Lartë. Edhe pse ajo ka administruar gjatë procesit gjyqësor aktet e paraqitura nga Avokatura e Shtetit, nga të cilat ka rezultuar se vendimi i gjykatës së apelit është komunikuar dhe është regjistruar në librin e dokumenteve që kanë hyrë në institucion (i cili mbahet dhe plotësohet nga nëpunësi përgjegjës për pranimin e tyre), në të njëjtën datë me atë të dëftesës së komunikimit, ky fakt nuk gjen pasqyrim në vendim dhe as qëndrimi i vetë Avokaturës së Shtetit në seancë gjyqësore. Për rrjedhojë, mënyra e arsyetimit të asaj gjykate dhe argumentet e paraqitura për të arritur në përfundimin se rekursi është paraqitur brenda afatit ligjor e çojnë këtë arsyetim në kufijtë e arbitraritetit, duke e bërë gjykimin të padrejtë.

33. Për sa i përket pretendimit tjetër të kërkuesit në këndvështrim të standardit të arsyetimit, që lidhet me mënyrën e vlerësimit të shkaqeve të rekursit dhe në veçanti çështjes së kompetencës lëndore, Gjykata vlerëson të mos ndalet në trajtimin e tij, për sa kohë që vetë qëndrimi i Gjykatës së Lartë për marrjen në shqyrtim të këtyre shkaqeve, të paraqitura tej afatit ligjor, është konsideruar jokushtetues.

34. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, për shkak të pranimit për shqyrtim të një rekursi të paraqitur jashtë afatit ligjor, është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-4492 (413), datë 1.12.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 14.11.2023.
Shpallur, më 13.12.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi